



Titulli i projektit

Rehabilitimi i Qendrës Kulturore

Tipi i projektit

Kohesion Social

Vendndodhja
e projektit

Katund i Ri

Buxheti i paravlerësuar

430,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza
e problemit/eve

Në të gjithë zonën e Bashkisë së Re Durrës, duke përjashtuar qytetin e Durrësit, vetëm në Katundin e Ri ka një qendër të vetme multi-kulturore me një kapacitet prej 400 personash. Qendra është në pronësi publik. Edhe pse kjo qendër mund të mirëpresë një numër të konsiderueshëm dashamirësish të aktiviteteve kulturore, gjendja në të cilën ajo ndodhet ul ndjeshëm frekuentimin e saj. Vihet re që kjo qendër ka nevojë për rehabilitim të ambjentëve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar një qëndrim sa më të këndshëm të frekuentuesve të saj dhe zhvillime cilësore të aktiviteteve kulturore. Alternativa është një jetë kulturore e banorëve ruralë e kufizuar në kafetë e fshatit ose në pikat e llotove të ndryshme.

Qëllimi/et specifik
të projektit

Qëllimi i rikonstruksionit të qendrës kulturore është krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për aktivitete kulturore, rinore dhe manifestime publike të ngjashme, duke i dhënë Katundit të Ri një rol të rëndësishëm në organizimin e aktiviteteve social-kulturore për të gjithë zonën. Për nga afërsia gjeografike, këtu mund të vijnë dhe banorë nga Sukthi dhe Manza, si dhe nga njësi të tjera.

Rezultatet e pritshme
dhe treguesit

Përfitimet e këtij projekti mund të përmblihen në:

- përfshirje më e madhe e banorëve (kryesisht të rinjve) të kësaj njësie administrative në aktivitetet kulturore;
- përmirësimi i kohezionit social;
- përmirësimi i cilësisë së jetës.

Nga rikonstruksioni i Qendrës Kulturore do të përfitojnë jo vetëm 10161 banorët e Katundit të Ri, por gjithë banorët e zonës funksionale (175,110 banorë, pse jo dhe Durrësi). Numri i njësie administrative që përfitojnë nga kjo ndërhyrje është 6 (gjashtë).

PROJEKTI 2



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt e projektit është 6 muaj – 1 vit.
Parashikohet që projekti të zbatohet në një periudhë të përshtatshme klimatike dhe në përputhje me kalendarin e aktiviteteve kulturore të qendrës.
Aktivitetet e parashikuara përfshijnë kryerjen e punimeve të brendshme dhe të jashtme rikonstruksioni, si dhe rehabilitimin e infrastrukturës audio.

Maturimi i projektit

Parashikohet të kryhet një vlerësim i situatës së godinës së qendrës kulturore. Në bazë të këtij vlerësimi do të kryhet një llogaritje e detajuar e nevojave për ndërhyrje (teknike dhe financiare).
Faza a dytë do të jetë përgatitja e termave të referencës, prokurimi, kontraktimi dhe zbatimi.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimi i mundshëm i financimit është fondi i Ministrisë së Kulturës për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve kulturore. Ndër partnerët e mundshëm në zbatimin e këtij projekti përfshihen Bashkia Durrës (njësia administrative Katund i Ri), organizata të ndryshme kulturore, etj..

Kostot e projektit

Kostot e projektit parashikohen të jenë nga 200,000 deri në 650,000 Euro, në varësi të pajisjeve.